



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 01/60
Datë: 05.02.2022

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 04/2021, bazuar në Vendimin e Kuvendit të Republikës së Kosovës Nr.08-V-173, të datës 29.12.2021, për miratimin e Vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr.01/51, të datës 24.12.2021 për masat e emergjencës në furnizimin e energjisë, në pajtim me nenin 17 dhe 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 5 shkurt 2022, merr këtë:

V E N D I M

1. Qeveria e Republikës së Kosovës zotohet për subvencionimin e energjisë në shumë prej 90,000,000.00 € (nëntëdhjetë milionë euro), për të ulur ndikimin e tarifave të energjisë te konsumatorët, duke marrë parasysh rritjen enorme të çmimeve të importit, rrjedhimisht krizën energjetike në të cilën ndodhet vendi.
2. Obligohet Ministria e Ekonomisë dhe Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve për zbatimin e këtij Vendimi, në pajtim me legjislacionin për financat publike.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë